



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:057712
Datë: 11.06.2024
Numri i dokumentit: 05806371

Ac.nr.8139/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dardan Kadolli, kryetar i kolegjit, Besnik Bisliraj dhe Burim Shala, anëtar të kolegjit, në çështjen kontestimore të paditësit R. R. nga Mitrovica, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson L. A., avokat me seli në rr. “A. Zh.” në Mitrovicë, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore, Drejtoria Komunale e Shëndetësisë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Liberta Bajrami, me objekt kontesti kompensim i shpërblimit jubilar, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.373/2021, i datës 17.06.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 11.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditësit R. R. nga Mitrovica, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.373/2021, i datës 24.10.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.373/2021, i datës 24.10.2022, ka vendosur: I. **REFUZOHET** kërkesëpadia e paditësit R. R. nga Mitrovicës, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës - Drejtoria Komunale e Shëndetësisë, me të cilën ka kërkuar kompensimin e të ardhurave në emër të shpërblimit jubilar, për dhjetë (10) vite të përvojës së punës dhe atë në lartësi prej 711.18 (*me fjalë: shtatëqind e njëmbëdhjetë euro e tetëmbëdhjetë cent*) euro me kamatë ligjore prej 8%, në tërësi si e pa bazuar. II. Obligohet paditësi R. R. që të paditurës Komuna e Mitrovicës - Drejtoria Komunale e Shëndetësisë, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, t’ia paguaj shumën prej 135 euro në afat prej 7 ditësh nga dita marrjes së këtij Aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur paditësi, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet ashtu që të aprovohet kërkesëpapia e paditësit si e bazuar dhe të detyrohet e paditura që paditësit në emër të shpërblimit jubilar t'ia kompensojë një pagë në shumë prej 711,18 €, me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e ushtrimit të padisë. Po ashtu ka kërkuar që e paditura të ngarkohet me shpenzime të procedurës.

E paditura përmes përfaqësueses së saj, ka paraqitur përgjigje në ankesë përmes së cilës i ka kundërshtuar pretendimet ankimore të palës paditëse, me propozim që ankesa e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa e paditësit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi R. R., me datë 26.03.2021, përmes të autorizuarit të tij, ka parashtruar padi në gjykatën e shkallës së parë, për kompensimin e shpërblimit jubilar, me pretendimet se i njëjti është në marrëdhënie pune tek e paditura në QKMF Mitrovicë dhe se në bazë të Kontratës Kolektive Sektoriale të njëjtit i takon kompensimi nga e paditura, në vlerë të një page mujore në shumë prej 711.78 €, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, ka mbajtur shqyrtimin kryesor dhe pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.373/2021, të datës 24.10.2022, me të cilin e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se 'në bazë të Kontratës së punës më numër të protokollit 290 të datës 01.12.2018 të paditësi R. R., vërtetohet se paditësi ka lidhur kontratë punë me paditësen më datë 01.12.2018 për kryerjen e punëve dhe detyrave të punës ashtu siç është përcaktuar në kontratë. Nga shkresat të cilat gjinden në lëndë, shihet se paditësi i është drejtuar të paditurës më kërkesë për kompensimin në emër të shpërblimit jubilar, e cila mbanë datën 24.02.2021, e protokolluar nga e paditura më numër 10-120/08-00713633/21 e datës 24.02.2021, mirëpo nga shkresat që gjenden në lëndë, shihet se e paditura nuk ka thyer përgjigje në kërkesat e parashtruara. Në rastin konkret, paditësi nuk arritën që të provojnë pretendimet e tij sa i përket kompensimit në emër të shpërblimit jubilar, përderisa kjo kërkesë nuk është mbështetur në prova nëse me të vërtet paditësi i takon shpërblimi në emër të pagesës për shpërblimin jubilar, e për të vërtetuar këtë pretendim paditësi është dashur të paraqesin vërtetim të lëshuar nga institucioni ku ai punon, tutje, Gjykata në seancën e datës 13.10.2022 i ka pyetur palët se a kanë prova të tjera për të propozuar, para se gjykata të kaloi në

procedurën e administrimit të provave, mirëpo përfaqësuesi i tani paditësit nuk ka propozuar prova të tjera përpos atyre të cilat gjinden në shkresat e lëndës, andaj mbi këtë bazë, kërkesëpadia nuk është e mbështetur në prova dhe të njëjtën gjykata e refuzoi si të pabazuar. Gjykata me propozim të palës paditëse administroi edhe listën e pagës në emër të paditësit në të cilin pasqyrohet përvoja e punës prej 17 viteve, mirëpo e njëjta përvojë e punës shërben për llogaritjen e pagës dhe shtesës për shkak të përvojës së punës, nga e njëjta provë gjykata nuk mundi të vërtetoj faktin se kur paditësi i kishte mbushur 10 vite përvojës së punës dhe se në kohën e mbushjes së 10 viteve të përvojës së punës a kishte bazë ligjore përkatësisht kontratë kolektive në fuqi e cila do të shërbente si bazë për fitim e të drejtës për shpërblim jubilar.’

Për mënyrën e vendosjes, gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitave ligjore nga neni 17, paragrafi 3, pika 3.e lidhur me nenin 7 të LPK-së. Vendimin mbi shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në dispozitën nga neni 452, paragrafi 1 dhe 463, paragrafi 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të pretenduara dhe as në shkeljet nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore ngase sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Po ashtu nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditësit se aktgjykimi është përfshirë në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike ngase gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe disa fakte vendimtare nuk kanë qenë kontestuese. Nga provat që ka administruar gjykata e shkallës së parë është vërtetuar se paditësi është i punësuar tek e paditura në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr. Nexhat Çuni” në Mitrovicë, si doktor specialist i Mjekësisë Familjare dhe kjo provohet përmes Kontratës së Punës me nr.290, e datës 01.12.2018 derisa lartësia e pagës provohet nga lista e pagës, e datës 29.01.2021 nga e cila provohet fakti se paditësi ka gjithsej 17 vite përvoja pune dhe pagën bazë e realizon në shumë prej 659,00 €.

Gjykata e Apelit vlerëson se me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses, gjykata e shkallës së parë drejtë e ka zbatuar edhe të drejtën materiale, e kjo për faktin se me nenin 17 par. 3 nën 3.1 të KKS parashihet se “*Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë [...] Për 10 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të 1 page mujore të tij*”, ndërsa par. 4 i këtij neni

parashihet se “Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë, shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale pasi kontrata në fjalë nuk ka qenë në fuqi në kohën e arritjes së vitit jubilar të paditësit. Gjukata e Apelit vlerëson se dispozitat e KKS prodhojnë efekt juridik vetëm për të drejtat të cilat janë njohur me këtë kontratë, të cilat kanë arritur brenda periudhës kohore të vlefshmërisë së saj, pra vetëm për të drejtat që kanë lindur nga data 11.06.2018 e deri me datë 10.06.2021. Në këtë kuptim, meqë sipas listës së pagave e prezantuar si provë për përvojën e punës nga ana e paditësit, e datës 29.01.2021, rezulton se paditësi vitin jubilar prej 10 viteve të përvojës së punës e ka arritur në vitin 2011, kushtin për shpërblim jubilar për 10 vite të përvojës së punës e ka arritur para hyrjes në fuqi të Kontrata Kolektive Sektoriale në Kosovë, ndërsa e drejta për të kërkuar kompensimin në emër të pagave jubilarë i ka lindur me hyrjen në fuqi të Kontratës Kolektive Sektoriale në Kosovë, nga data 11.06.2018.

Në këtë kuptim, meqë padia është paraqitur me datë 26.03.2021, ndërsa vitin jubilar paditësi e ka arritur në vitin 2011, atëherë rezulton se në kohën e arritjes së vitit jubilar nuk ka qenë në fuqi Kontrata Sektoriale e Shëndetësisë (e cila nuk ka efekt prapaveprues), për çka edhe nuk ka pasur bazë juridike për ti njohur të drejtën për shpërblim jubilar dhe rrjedhimisht kërkesëpadia e paditësit në mungesë të një baze të tillë me të drejtë është refuzuar (bazuar edhe në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme Gj.A.nr.40/2023, datë 27.02.2023, pika V, ku shprehimisht ceket se kjo kontratë zbatohet prej datës 11.06.2018 deri me datë 10.06.2021).

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e nenit 450 të LPK-së.

Gjukata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, pasi që gjykata e shkallës së parë ka dhënë qëndrimin e saj juridik lidhur me to, të cilin e pranon në tërësi edhe kjo gjykatë e shkallës së dytë, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjukata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par. 1 pika d) të LPK-së, lidhur me neni 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
Ac.nr.8139/2022, datë 11.06.2024

Kryetari i Kolegjit, Gjyqtari
Dardan Kadolli